



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT
BASHKIA SKRAPAR
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 15.05.2020

Për: “ELMAZAJ KONSTRUKSION” SH.P.K me adresë FIER Lagjja "1 Maji" Rruga Jani Bakalli, zona kadastrale 8531, Nr. pasurie 5/399-N15, Pallati nr.88, Ap 39.

* * *

Procedura e prokurimit: **Procedur e Hapur**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-55005-03-26-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Blerje Fadrome e re për Nevojat e Ndërmarrjes se Shërbimeve Publike , Skrapar.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike **nr.17 date 30.03.2020**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës nëprocedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.“START CO” SH.P.K

L11614001S

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **7,199,000** (*shtatë milion e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë*) lekë pa tvsh
(*me numra dhe fjalë*)

2.“ZEQIRI” SH.P.K

J67902827A

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **7,470,000** (*shtatë milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë*)lekë pa tvsh
(*menumradhefjalë*)

3.”DenisaBeshaj”

L41904011K

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **9,490,000** (*nëntë milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë*)lekë pa tvsh
(*me numra dhe fjalë*)

4. "ELMAZAJ KONSTRUKSION" SH.P.K L33229401T
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera **9,980,000** (nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjete mijë) lekë pa tvsh
(me numra dhe fjalë).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1 Operatori ekonomik shoqëria "START CO" SH.P.K	L11614001S
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
2 Operatori ekonomik Denisa Beshaj – Person Fizik	L41904011K
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
3 Operatori ekonomik shoqëria "ZEQIRI" SH.P.K	J67902827A
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik shoqëria "START CO" sh.p.k. nuk plotëson pikën 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar: b. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim që ka paguar të gjitha taksat vendore në të gjitha pikat e ushtrimit të aktivitetit sipas ekstraktit të shoqërisë. Referuar ekstraktit mbi historikun e këtij operatori ekonomik rezulton se ka ushtruar aktivitet në adresat dytësore. Operatori ekonomik shoqëria "START CO" sh.p.k. nuk plotëson pikën 1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje) e cila nuk është paraqitur sipas formatit të përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit.

Nuk është plotësuar sipas formatit të përcaktuar në DST, konkretisht janë hequr pjesët që kanë të bëjnë me: Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

Gjithashtu, ka ndryshuar formatin në lidhje me detajimin e cmimit, jo sipas përcaktimeve të DST-ve.

Operatori ekonomik shoqëria "START CO" sh.p.k. nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga Autoritetit Kontraktor për mjetin Fadrome si më poshtë:

Viti I prodhimit për mjetin që ofrohet nuk specifikohet

Nuk përputhen marshat e kërkuara me ato të ofruara

Kapaciteti i serbatorit karburantit me i vogel 160 - 170 lit
ofrohet 150 lit.

Kapaciteti i vajit të motorrit 9-10 lit
ofrohet 8 lit.

Sistemi ftohes 20-23 lit.

Ofrohet 18.5 lit

Gjerësia e këmbëve mbrapa 2.35 m – 2.40 m, mjete që ofrohet nuk specifikohet.

Mjeti kërkohet me kapes të shpejt mekanik të krahut të prapme, mjeti që ofrohet nuk specifikohet. Krah mbrapa I gërmimit 4.3 m – 5.3 m, mjeti që ofrohet e ka të percaktuar qartë. Gjithashtu ka dhe të tjera mugesha ne specifikimet teknike te mjetit

Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik shoqëria “START CO” sh.p.k. është ofertë anomalisht e ulët.

Operatori ekonomik Denisa Beshaj – Person Fizik nuk ploteson piken 2.3 Kapaciteti teknik: a. Dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit, në vlerë jo më pak se 40 % të fondit limit që prokurohet. Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata me institucionet shtetërore për përvojën e mëparshme duhet të paraqiten vërtetime realizimi të lëshuara nga institucionet perkatese me të cilat keni realizuar kontratën, ku shënohen datat, shumat, sasite dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të firmosura e të konfirmuara nga bleresi dhe shitesi ku të percaktohen qarte, datat, shumat, sasite dhe shërbimet e realizuara.

Operatori Ekonomik Denisa Beshaj nuk kualifikohet pasi :

- nuk permbush kerkesen e dst ,shtojca 10,specifikimet teknike .Per kete nuk ka paraqitur asnje material te kerkuar qe te beje te mundur qe KVO -ja te gjykoje mbi mallin e ofruar nga Operatori Ekonomik ,ku per me teper qe ne piken 24,25,26 te kesaj shtojce jane kerkuar :

Pika 24 Pjeset te jepet liste e detajuar pjesesh per servisimin e mjetit deri ne 6000 ore pune sipas programit te mirembajtjes nga prodhuesi dhe me cmimet specifike per cdo pjese qe Ndermarrja ti kete si referenc per mirembajtjen dhe shites i autorizuar ne Shqiperi per keto pjese.

Pika 25 Katalogu i makineris bashkë me foto te makineris gjithashtu shasia e mjetit dhe motorrit dhe transmisionit.

Pika 26 Autorizim nga Prodhuesi ose shitesi Zyrtar i tij.

Operatori ekonomik shoqëria “ZEQIRI” sh.p.k. nuk plotëson pikën 1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje); jo sipas formatit ne dst.

Nuk është plotësuar sipas formatit të përcaktuar në DST, konkretisht ka shënuar si procedure prokurimi “Kerkese per propozim”, kurse referuar DST-ve procedura e aplikuar per kete procedure prokurimi eshte e hapur me mjete elektronike.

Operatori ekonomik shoqëria “ZEQIRI” sh.p.k. nuk plotëson pikën b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1. Nuk është paraqitur një deklaratë e tillë.

Operatori ekonomik shoqëria “ZEQIRI” sh.p.k. nuk ploteson kerkesat e DST per shtojcen 10 ,specifikimet teknike .Kriteret e specifikuara ne DST krahasuare me mjetin e ofruar:

Viti i prodhimit nuk specifikohet

Fuqia e kerkuar e mjetit 64-65 kw, mjeti qe ofrohet e ka 63 kw (86 hp)

Pesha operuese e mjetit kerkohet 8000-8500 kg, mjeti qe ofrohet nuk specifikohet.

Dritat nuk specifikohen ne mjetin e ofruar

Kabina e manovratorit nuk specifikohet

Krahu mbrapa I germimit 4.3 m – 5.3 m, mjeti qe ofrohet nuk e ka te percaktuar .

Mjeti kerkohet te kete kondrapeshe 100kg – 115 kg, mjeti qe ofrohet nuk specifikohet

Gjeresia e kembeve mbrapa nuk specifikohen

Kapaciteti i serbatorit , te kerkuare 160-170 lit.

ofrohet 129 lit.

Sasia e vajit te diferencialit nuk specifikohet

Sistemi add blue 0 lit. nuk specifikohet

Pjeset pika 24 ku kerkohet te jepet liste e detajuar pjesesh per servisimin e mjetit deri me 6000 ore pune sipas programit te mirembajtjes nga prodhuesi dhe me cmimet specifike per cdo pjese qe Ndermarrja ti kete si referenc per mirembajtjen dhe shites i autorizuar ne Shqiperi per keto pjese Nuk ka paraqitur fare nje liste te tille me cmime . Gjithashtu ka dhe te tjera muges ne specifikimet teknike te mjetit .

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“ELMAZAJ KONSTRUKSION” SH.P.K** me adresë FIER Lagjja "1 Maji" Rruga Jani Bakalli, zona kadastrale 8531, Nr. pasurie 5/399-N15, Pallati nr.88, Ap 39. se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **9,980,000 (nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë)lekë pa tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ndërmarrjes e Shërbimeve Publike ,Skrapar* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit,brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **07.05.2020**

Ankesa: ka ose jo JO

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR /OSE PERSONI I AUTORIZUAR PREJ
TIJ**

Edmond OMERI